



Partia Demokratike e Shqipërisë

Nr. Prot 19 .

Datë 21/02/2018

Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Lënda: Deklarimi pasqyrave financiare 2017

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 261
DATE 28 02 2018

E/I Nderuar,

Bashkelidhur po ju dergojme pasqyrat e financiare per vitin financiar 2017.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin,

Drejtor Finance

Illir Dervishi



Partia Demokratike e Shqipërisë

Forma juridike: Parti Politike

Data e themelimit: 12 dhjetor 1990

Numri unik i indentifikimit(NIPT): K51919009E

Adresa e Selisë: Bulevardi Zhan d'Ark 11,1000, Tiranë

PASQYRAT FINANCIARE 2017

(Mbyllur më 31.12.2017)

Pasqyra financiare: Individuale

Periudha kontabël: Nga 01.01.2017 deri më 31.12.2017

Data e mbylljes: 20 Shkurt 2018

Monedha: Lekë

Shkalla e rrumbullakimit: Lekë

Tiranë, Shkurt 2018

TABELA E PERMBAJTJES

A. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
B. PASQYRA E AKTIVITETEVE.....	4
C. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVEONETARE.....	5
D. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE.....	6-12

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017

(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEK, PËRVEÇ KUR SHPREHET NDRYSHE)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
I AKTIVET				
1	Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5	7,427,787	29,555,160
2	Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		-	-
3	Kontribute të arkëtueshme		-	-
4	Inventarë dhe shpenzime të parapaguara	6	120,000	120,000
5	Investime financiare afat gjata		-	-
6	Aktive të kufizuara		-	-
7	Toka, ndërtesa dhe pajisje	7	40,183,983	45,527,375
8	Investime të tjera afatgjata		-	-
Totali i aktiveve (I)			47,731,770	75,202,535
II DETYRIMET				
1	Të pagueshme	8	4,750,648	4,134,702
2	Dëftesa të pagueshme		-	-
3	Kontribute të marra në avancë		-	-
4	Grante		-	-
5	Premtime të kushtëzuara për të dhënë		-	470,722
6	Hua afat gjatë		-	-
Totali i detyrimeve (II)			4,750,648	4,605,424
III AKTIVET NETO				
1	Të kufizuara			
	Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për		-	-
	Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe		-	-
2	Të pakufizuara		42,981,122	70,597,111
Totali i aktiveve neto (III)			42,981,122	70,597,111
TOTALI AKTIVIT NETO DHE DETYRIMEVE			47,731,770	75,202,535

Shenimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë perberese e ketyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCËS)

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017

(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEK, PËRVEÇ KUR SHPREHET NDRYSHE)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
A Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara :				
	Të ardhurat :	9		
	Të ardhura nga tarifat e antarësimit		181,045	
	Të ardhura nga donacionet dhe kontrib. vullnetare		22,889,253	
	Të ardhura nga grantet, qeveritare, agjenci të tjera		108,157,230	57,179,867
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet		-	
	Tarifat për shërbimet		-	-
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare		-	-
	Të ardhura të tjera		-	-
	Totali i të ardhurave		131,227,528	57,179,867
			-	
	Aktive neto të çliruara nga kufizimet:			
	Realizimi i kufizimeve të programit		-	-
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		-	-
	Përfundimi i kufizimit të afatit		-	-
	Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		-	-
	Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:		131,227,528	57,179,867
	Shpenzime për aktivitetet	10		
	Aktiviteti-Fushata zgjedhore për Kuvendin 2017		(97,218,467)	-
	Shpenzime administrimi e të tjera të përgjithshme		(61,625,050)	(61,055,372)
	Krijim dhe rritje fondesh (Sistemim)		-	4,188,137
	Totali i shpenzimeve		(158,843,517)	(56,867,235)
	Rritja / Rënja në aktivet neto të pakufizuara (A)		(27,615,989)	312,632
B Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara :				
	Kontributet		-	-
	Të ardhurat nga investimet afat gjata		-	-
	Fitimi i realizuar dhe i përealizuar nga invest. afatgjata		-	-
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		-	-
	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (minus)		-	-
	Rritja / Rënja në aktivet neto përkoh. të kufizuara (B)		-	-
C	Ndryshimi në aktivet neto (A + B)	11	(27,615,989)	312,632
	Aktive neto në fillim të vitit		70,597,111	70,284,479
	Aktive neto në fund të vitit		42,981,122	70,597,111

Shenimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë perberese e ketyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2017

(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEK, PËRVEÇ KUR SHPREHET NDRYSHE)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
I	AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT			
	NDRYSHIMET NE AKTIVET NETO		(27,615,989)	312,632
	Rregullimet për përputhjen e ndrysh. në aktivet neto			
	Amortizimi dhe zhvlerësimi		5,343,391	6,244,705
	Humbjet e realizuara dhe të perealizuara në investime			
	Humbjet nga dalja jashtë përdor. e makineri pajisjeve		-	-
	Kontributet jo në para		-	-
	Rritjet/ Rëniet jo në para të inventarëve		-	-
	Kontributet e kufizuara për invest.në dhurime/ ndihma		-	-
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:			
	Të tjera të arkëtueshme		-	-
	Shpenzime të parapaguara			
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme			
	Të pagueshme		145,225	687,084
	Bamirësi mbi baza vjetore			
	Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		(22,127,373)	7,244,421
II	AKTIVITETET INVESTUESE			
	Blerje / Shitje investimesh		-	
	Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata		-	(2,325,522)
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		-	
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		-	
	Flukse neto nga aktivitetet investuese		-	(2,325,522)
III	AKTIVITETET FINANCUESE			
	Arkëtime kontrib. e kufiz. për invest.,dhurime/ndihma			-
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme			
	Flukse neto nga aktivitetet financuese		-	-
IV	Rritje/Rënie neto e mjeteve monetare(I+II+III)		(22,127,373)	4,918,899
	Mjete monetare dhe ekuivalentë,në fillim të periudhës		29,555,160	24,636,261
	Mjete monetare dhe ekuivalentë, në fund të periudhës		7,427,787	29,555,160
	Mjete monet. të paguara gjatë periudh. për interesa		-	-
	Mjete monet. të paguara gjatë periudh. për tatim taksa		-	-

Shenimet mbi pasqyrat financiare ne faqet vijuese jane pjese perberese e ketyre pasqyrave financiare.Keto pasqyra financiare jane aprovuar nga Bordi Financiar i Partisë:

Drejtori i Finances
Ilir Dervishi

I Ngarkuari i Kryesise
Arben Ibroja

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

(TË GJITHA SHUMAT JANË NË LEK, PËRVEÇ KUR SHPREHET NDRYSHJE)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Partia Demokratike e Shqiperisë është themeluar me 12 dhjetor 1990 dhe vepron në përputhje me ligjin nr.8580 date 17.02.2000 "Për Partite Politike", i ndryshuar, Statutin e saj dhe kuadrin ligjor shqiptar. Ajo është një organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë në strukturat e saj, të organizuara mbi bazën e ndarjes territoriale të vendit dhe i realizon objektivat e veta politike nëpërmjet komunikimit politik përmes zgjedhjeve.

Veprimtaria ekonomike e partisë administrohet nga Bordi Financiar i Partisë, i cili kontrollon përdorimin rigoroz të financave të partisë dhe shqyrton raportet financiare para dorëzimit të tyre në organet kompetente shtetërore dhe të partisë.

Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike, si dhe nga çdo burim tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

2. DEKLARATE E PAJTUESHMERISE ME SKK-të PER OJF-të

Pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurese (SKK për OJF-të), dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3. BAZAT E MATJES TE PERDORURA

Pasqyrat financiare, përveç informacionit të flukseve të mjeteve monetare, janë përgatitur duke përdorur bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, aktive neto, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra.

Për matjen e vlerave monetare të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në pasqyrat e saj financiare, partia ka zgjedhur si bazë matjeje kosto historike dhe në raste të veçanta baza të tjera matjeje të lejuara nga standardet.

Paraqitja e tyre është bërë në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL ME TE RENDESISHME PER KUPTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

4.1 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare për veprimtari të shfrytëzimit, aktivitet investuese ose financuese.

4.2 Të drejta të arkëtueshme dhe të pagueshme

Matja fillestare e të arketueshmeve dhe pagueshmeve bëhet me vlerën e drejte dhe me pas njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metoden e interesit efektiv minus provizionet për zhvleresim. Interesi mbi të arketueshmet e pakthyera njihet mbi bazën e kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

4.3 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 04-Inventarët, kur subjekti i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërish, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit. Vlerësimi i mëpasshëm, pas njohjes fillestare, matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

4.4 Toka, Ndertesa, Pajisje

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktiviteti kontrollohet nga partia, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitetit të hyrë dhe kostoja e aktivitetit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi dhe matet me koston.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Koston që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Koston që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës së vlerës se mbetur për të gjitha vitet e jetës ekonomike të aktivitetit, me norma vjetore, ndertesat 5% dhe të tjerat 20%.

4.5 Të ardhura dhe shpenzime

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse, gjatë periudhës së raportimit, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në rritjen e aktiveve neto të pakufizuara.

Shpenzimet janë flukse dalëse, gjatë periudhës raportuese, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në pakësimin e aktiveve neto të pakufizuara.

Kontributet e marra njihen si të ardhura ose fitime në periudhën kur merren dhe si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë. Kontributet e marra paraqiten si ndihma të kufizuara ose të pakufizuara. Kur merr kontribute në shërbime partia i përshkruan ato në programet apo aktivitetet për të cilat janë përdorur këto shërbime, përfshirë natyrën dhe shkallën e kontributit për periudhën si dhe shumën e njohur si të ardhur për periudhën.

Kontributet e dhëna do të njihen si shpenzime në periudhën kur janë dhënë dhe si pakësim i aktiveve apo shtim i detyrimeve, në varësi kjo të formës së përfitimit të dhënë. Kontributet e dhëna maten me vlerën e drejtë të aktivitetit të dhënë ose, nëse janë në formën e shuarjes së një detyrimi të përfituesit të donacionit, do të maten me vlerën e drejtë të detyrimit.

4.6 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot). Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me koston historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë

periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin. Kurset e këmbimit, të përdorura për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2017 janë 1 euro=132.95 Lekë, CHF=113.94 dhe 1 dollar=111.10 Lekë.

4.7 Aktive neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Aktivët neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ndahen në: - aktive neto të kufizuara, dhe - aktive neto të pakufizuara sipas percaktiveve të standardit kontabel për OJF-të. Ndryshimi në aktivët neto rezulton nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit për periudhën.

INFORMACION MBESHTETES PER ZERAT E PARAQITUR NE PASQYRAT FINANCIARE, NE RENDIN NE TE CILIN PARAQITEN NE CDO PASQYRE DHE ZE PERKATES

5. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Gjendjet e mjeteve monetare ne bankë dhe arke, ne fillim dhe fund te ushtrimit jane si me poshte:

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
1	Mjete Monetare ne Arke	44,116	418,749
2	Mjete Monetare ne Bankë	7,383,671	29,136,411
3	Investime në Tregje shume Likuide	-	-
Totali		7,427,787	29,555,160

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund te ushtrimit. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj jane perkthyer ne Lek duke perdorur kursin e kembimit te shpallur nga Banka e Shqiperise.

Ndërsa te analizuara sipas bankave, llogarive bankare dhe monedhes funksionale ato paraqiten si vijon:

Nr	Llogaritë bankare	Viti Raportues 31.12.2017				Totali në monedhën-Lekë
		LEKE	EURO	USD	CHF	
1	I.C. Bank në lekë(000203/01)	4,105,560				4,105,560
2	I.C. Bank në EURO (000309/01)		8.00			1,064
3	I.C. Bank në USD(000202/07)			1,058.24		117,570
4	Raiffeisen Bank 0101003045, në lekë	2,193,600				2,193,600
5	Raiffeisen Bank 0090003045, në lekë	(1,008)				(1,008)
6	Raiffeisen Bank 8020003045 ne EURO		(5.00)			(665)
7	Raiffeisen Bank 6000003045 ne EURO		5,000.00			664,750
8	Raiffeisen Bank 8800003045 - EUR		(21.44)			(2,850)
9	Raiffeisen Bank 8030003045 ne USD			202.35		22,481
10	Raiffeisen Bank 8010003045 ne CHF				1,045.43	119,116
11	Credins Bank 168634 në lekë	164,738				164,738
12	Credins Bank në lekë 647336	(3,090)				(3,090)
13	Credins Bank 169085 në USD			21.65		2,405
Shuma e bankave		6,459,800	4,981.56	1,282.24	1,045.43	7,383,671

Llogaritë e zbuluara bankare per shkak te materialitetit te vogel jane paraqitur me minus në aktiv.

6. Inventarë dhe shpenzime të parapaguara

Inventari përfaqëson vlerën e materialeve ndihmëse të partisë, më 31.12.2017, si më poshtë:

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
1	Materiale	120,000	120,000
Totali		120,000	120,000

Shuma e inventarit "Materiale" është paraqitur me koston e blerjes, e cila është vlerësuar si vlera më e ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

7. Toka, ndërtesa dhe pajisje

Vlera neto kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata materiale (AAM-te) paraqiten si vijon:

Nr	Pershkrimi i Elementeve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
1	Ndertime	23,826,519	25,080,546
2	Makineri, linja teknologjike e paisje	17,205	21,506
3	Mjete motorike (automjete)	5,953,975	8,030,858
4	Mobilie, orëdi, pajisje zyre	8,778,241	10,384,412
5	Programe dhe pajisje informatike	1,608,043	2,010,053
Totali		40,183,983	45,527,375

Si politikë kontabël për ndjekjen e AAM-ve, partia ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me koston dhe në datën e mbylljes së PF-ve paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga rënia e vlerës. Për vitin ushtrimor 2017 nuk ka patur shtesa dhe pakesime të AAM-ve. Si pakësim në vlerën neto të tyre janë vetëm shpenzimet e amortizimit vjetor për shumën 5,343,391 lekë, llogaritur sipas politikave kontabël. Drejtimi nuk ka llogaritur rënie të vlerës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017.

8. Të pagueshme

Detyrimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel paraqiten:

Pershkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
Detyrimi për Furnitore	4,750,648	4,605,424

Të pagueshme ndaj furnitoreve pasqyron detyrimet nga blerja e mallrave dhe shërbimeve të mbetura pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitoreve dhe llogarive të tjera të pagueshme janë paraqitur me vlerën e tyre reale.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur detyrimet e mbetura pa u paguar në fund të vitit 2017.

9. Të ardhurat

Te ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit sipas burimit (kategorive) te biznesit paraqiten si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
Të ardhurat			
1	Të ardhura nga tarifat e antarësimit	181,045	-
2	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	-	-
	Donacion në mjete monetare	-	-
	Donacion në natyrë,kohe televizive, qera etj	22,889,253	-
3	Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të fina	108,157,230	57,179,867
4	Të ardhura nga investimet apo dhurimet	-	-
5	Tarifat për shërbimet (qeradenia)	-	-
6	Të ardhura nga aktivitetet tregtare	-	-
7	Të ardhura të tjera	-	-
Shuma		131,227,528	57,179,867

Në "Të ardhura nga tarifat e antarësimit" jane pasqyruar shumat e kuotizacionet e anëtarësisë te arketuara gjate vitit 2017.

Në zërin „Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare“ jane pasqyruar donacionet dhe kontribute në natyrë të analizuara si më me poshtë:

Nr	Fatura Datë	Donatorët	Shuma
292	16-06-17	Media Vision sh.a	700,000
40	14-06-17	TOP CHANNEL sh.a	10,351,200
651	20-06-17	TOP CHANNEL sh.a	9,000,000
654	21-06-17	TOP CHANNEL sh.a	1,099,200
Extra		Qeraja e zyrave elektorale-grup(vleresim i E.F)	1,738,853
Totali donacione			22,889,253

Donacionet nga kompanitë e mediave janë të dokumentuara me faturë tatimore dhe në secilen prej tyre është ndarë shërbimi me pagesë dhe shërbimi falas i kohës televizive. Donacionet në natyrë për pëdorimin e zyrave elektorale bazohet ne vleresimin e Eksperteve Financiar,të caktuar nga KQZ-ja dhe jane regjistruar ne te ardhura dhe shpenzime me kete dokument vleresimi.

Në "Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit" jane përfshirë të gjitha financimet buxhetore të marra nga 1 janari deri në 31 Dhjetor 2017, ne shumen totale 108.157.230 leke.

10. Shpenzime për aktivitetet

a) Shpenzimet vjetore sipas natyrës

Shpenzimet për aktivitetet perbehen nga materiale e shërbime të konsumuara gjatë ushtrimit, shpenzimet e personelit për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nga shpenzime të tjera të funksionimit. Përveç aktivitetit normal të partisë për vitin 2017 u zhvillua dhe fushata zgjedhore për Kuvendin, i cili pasqyrohet si aktivitet me vetë.

Shpenzimet e aktivitetit vjetor janë paraqitur sipas natyrës së tyre në tabelën vijuese.

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2017	Viti Paraardhës 31.12.2016
1	Materiale të konsumueshme		
	Shpenzime të tjera	(7,959,654)	(2,923,569)
	Energji uje	(3,404,540)	(3,802,699)
2	Shpenzime personeli		
	Paga dhe shpërblime	(25,260,922)	(26,220,453)
	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	(4,034,604)	(4,086,400)
3	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(5,343,391)	(6,244,705)
4	Shpenzime të tjera		
	Sherbime dhe konsulenca	(31,264,480)	-
	Qera ambientesh	(2,514,063)	(3,781,660)
	Qera ambientesh-donacione individuale për fushatën zgjedhore	(1,738,853)	-
	Sherbime televizive-Trasmetime live, spotesh, reklama	(55,040,735)	-
	Sherbime foni, stage, ndricim etj	(10,000,000)	-
	Trasferime, udhëtime, dieta	(1,099,000)	-
	Shpenzime postare dhe të komunikimit online	(4,285,194)	(3,359,507)
	Shpenzime për shërbimet bankare	(88,703)	(27,623)
	Kuota antaresimi në org.nderkombetare	(790,650)	-
	Taksa dhe tarifa vendore	(31,250)	(11,717)
	Subvencione të dhëna -Gazeta Rilindja Demokratike, etj.	(5,000,000)	(5,673,870)
	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	(48,600)
	Gjoha dëmshpërblime	(420)	-
	Të tjera		(306,498)
5	Të ardhura dhe shpenzime financiare	(990,058)	(379,934)
TOTALI I SHPENZIMEVE		(158,843,517)	(56,867,235)

b) Shpenzimet e vitit raportues ndarë sipas aktiviteteve

Ndarja e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas destinacionit, midis aktivitetit normal të funksionimit të partisë dhe aktivitetit të fushatës zgjedhore për kuvendin 2017 është bërë mbi bazën e destinacionit të çdo shpenzimi.

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2017	Ndare sipas aktiviteteve	
			Shpenzime të aktivitetit normal	Fushata zgjedhore për Kuvendin 2017
1	Materiale të konsumueshme	-	-	-
	Shpenzime të tjera	(7,959,654)	(3,923,654)	(4,036,000)
	Energji uje	(3,404,540)	(3,404,540)	-
2	Shpenzime personell	-	-	-
	Paga dhe shpërblime	(25,260,922)	(25,260,922)	-
	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësor	(4,034,604)	(4,034,604)	-
		-	-	-
3	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(5,343,391)	(5,343,391)	-
		-	-	-
4	Shpenzime të tjera	-	-	-
	Sherbime dhe Konsulenca	31,264,480	(4,858,602)	(26,402,878)
	Qera ambientesh	(2,514,063)	(2,514,063)	-
	Qera ambientesh-donacione indivi. për fushatën zgjedhore	(1,738,853)	-	(1,738,853)
	Sherbime televizive-Trasmetime live, spotesh, reklama	(55,040,735)	1	(55,040,736)
	Sherbime foni, stage, ndricim etj (fushata)	(10,000,000)	-	(10,000,000)
	Trasferime, udhëtime, dieta	(1,099,000)	(1,099,000)	-
	Shpenzime postare dhe telekomunikimi, facebook	(4,285,194)	(4,285,194)	-
	Shpenzime për shërbimet bankare	(88,703)	(88,703)	-
	Kuota antaresimi në org. ndërkombëtare	(790,650)	(790,650)	-
	Taksa dhe tarifa vendore	(31,250)	(31,250)	-
	Subvencione të dhëna - Gazeta Rilindja	(5,000,000)	(5,000,000)	-
	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	-	-	-
	Gjoha dëmshpërblime	(420)	(420)	-
	Të tjera	-	-	-
		-	-	-
5	Te ardhura dhe shpenzime financiare	(990,058)	(990,058)	-
		-	-	-
TOTALI I SHPENZIMEVE		(158,843,517)	(61,625,050)	(97,218,467)

Aktivet Neto

Aktivet neto të Partisë Demokratike në fund të vitit 2017 janë 42,981,122 leke dhe janë aktive neto të pakufizuara.

Ndërsa ndryshimi i aktivitetit neto për vitin 2017 që rezulton nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit për periudhën është në shumën minus 27,615,989 Lekë.

SHENIME TË TJERA SHPJEGUESE

Pasqyrat financiare të vitit 2016 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit për OJF (SKK-te e përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2016 janë riparaqitur sipas ketyre zerave.